



DËSHTIMI I DREJTËSISË NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT



Prishtinë, Prill 2023

Autorë: Gzim Shala dhe Lavdim Makshana

Me kontribut të veçantë: Elsa Kollqaku

Redaktorë: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Prill, 2023
Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	4
Pjesa I: Ndjekja e korrupsionit.....	5
2. Ngarkesa e sistemit prokurorial me lëndë të korrupsionit	6
3. Aktakuzat e ngritura.....	6
4. Profili i të akuzuarve.....	7
5. Ndjekja e (ish) zyrtarëve të lartë.....	8
6. Koha e kryerjes së veprave penale për të cilat është ngritur aktakuza	8
7. Dëmi sipas aktakuzave.....	9
8. Provat e prokurorisë.....	10
9. Sekuestrimi dhe Konfiskimi	13
Pjesa II: Gjykimi i korrupsionit	14
10. Gjykimi i korrupsionit në shkallë të parë	15
11. Vjetërsia e lëndëve aktive në gjyqësor	15
12. Gjykimi i korrupsionit në shkallë të dytë	17
13. Politika ndëshkimore në rastet e korrupsionit	18
14. Mos aplikimi i dënimeve plotësuese	19
15. Administrimi jo adekuat i rasteve të korrupsionit: Nevoja për gjyqtarin zëvendësues	20
16. Parashkrimi i korrupsionit.....	21
17. Zbatimi i planeve të brendshme kundër korrupsionit	23

1. Përmbledhje ekzekutive

Lufta kundër korrupsionit vazhdon të mbetet pothuajse sfida kryesore e sistemit të drejtësisë edhe përkundër miratimit të politikave të avancuara, as gjatë vitit 2022 nuk janë arritur rezultate. Gjatë vitit 2022, Prokurori i Shtetit ka pësuar regres në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit. Kjo pasi numri i rasteve të pazgjidhura ka shënuar ngritje për gjithsej 314 lëndë. Në anën tjetër edhe në gjykata, numri i lëndëve të pazgjidhura ka shënuar rritje, përkundër që qëllimi ishte zvogëlimi i këtij numri, në fund të vitit 2022, ky numër u ngrit për tetë (8) lëndë, dhe numri i personave u ngrit për 11 persona.


Sa i përket profilit të të akuzuarve, nga 98 personat e akuzuar, vetëm shtatë (7) prej tyre konsiderohen të akuzuar të profilit të lartë. Shprehur në përqindje rezulton se vetëm 8% e të akuzuarve i përkatësin profilit të lartë. Për më tepër, akuzimi i ish-zyrtarëve si karakteristikë e ndjekjes penale të korrupsionit të profilit të lartë ka qenë e theksuar edhe gjatë vitit 2022. Kjo pasi nga tetë (8) personat e profilit të lartë, vetëm ndaj njërit prej tyre ishte ngritur aktakuzë gjatë kohës sa ka qenë zyrtar. Si pozitive konsiderohet fakti se numri më i madh i aktakuzave të ngritura gjatë vitit 2022 kanë të bëjnë me veprat penale që dyshohen të jenë kryer relativisht vonë. Mirëpo, ky efikasitet i Prokurorit të Shtetit nuk ka ndodhur në të gjitha rastet. Kjo pasi, në dy (2) raste ku akuzohen gjashtë (6) persona janë ngritur aktakuza për vepra penale që dyshohet të jenë kryer qysh në vitin 2015.

Prokurori i Shtetit nuk ka përcaktuar fare në aktakuzë dëmin që pretendohet të jetë kryer nga vepra penale ndaj 22 personave të akuzuar për korrupsion. Sa i përket dëmit të pretenduar në aktakuzat tjera të prokurorisë, dominon vlera e dëmit në mes 10.000 mijë deri në 50.000 euro. Rasti me dëmin më të lartë të pretenduar nga Prokuroria është aktakuza në rastin “53 milionëshi”, ndaj ish-ministrit Pal Lekaj dhe tre (3) të akuzuarve të tjerë.

Përtej afateve të përcaktuara me ligj, IKD gjatë monitorimit ka gjetur raste të korrupsionit të cilat janë aktive në gjykatë, përkundër se aktakuza është ngritur në vitin 2009. Pra, afër 14 vite më parë. Në këtë drejtim, janë gjithsej nëntë (9) raste gjyqësore të korrupsionit, aktakuzat e të cilave janë ngritur nga viti 2009 deri në vitin 2015, e të cilat mbeten ende aktive në gjyqësor. Në trajtimin e lëndëve të korrupsionit nga Gjykata e Apelit, kthimi i lëndëve në rigjykim vazhdon të mbetet problematikë. Nga gjithsej 64 lëndë të vendosura në vitin 2022, Gjykata e Apelit kthej në rigjykim 21 prej tyre. Edhe politika ndëshkimore vazhdon të mbetet e butë, kjo pasi në 60% të rasteve, dënimet e shqiptuara për korrupsion kanë qenë dënime me gjobë. IKD ka gjetur se tetë (8) raste u kthyen në pikën zero pasi kishin kaluar tre (3) muaj nga data e seancës së fundit, ndërsa 15 raste të tjera u kthyen në pikën zero për shkak të mungesës së njërit prej anëtarëve të trupit gjykues.

Gjatë monitorimit të IKD-së për vitin 2022, është gjetur se nga 70 aktgjykime dënuese për korrupsion, vetëm ndaj 19 personave është shqiptuar dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksionit në administratën publike. Problematikë vazhdon të mbetet edhe parashkrimi, kjo pasi vetëm gjatë vitit 2022, u parashkruan rastet e 28 të akuzuarve për korrupsion.

NDJEKJA E KORRUPSIONIT



2. Ngarkesa e sistemit prokurorial me lëndë të korrupsionit

Gjatë vitit 2022, Prokurori i Shtetit ka pësuar regres në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit. Kjo pasi numri i rasteve të pazgjidhura të korrupsionit ka shënuar ngritje. Kjo ka ardhur si rezultat i asaj se gjatë vitit 2022, Prokurori i Shtetit nuk ka arritur që të zgjidhë lëndë aq sa edhe ka pranuar.

Përkatësisht, gjatë kësaj periudhe kohore, Prokurori i Shtetit ka zgjidhur lëndët e 826 personave derisa ka pranuar lëndë për 1140 persona. Kështu, në fund të vitit 2022, numri i lëndëve të pazgjidhura të korrupsionit është ngritur për gjithsej 314 lëndë.

Kjo ngritje e numrit të lëndëve të pazgjidhura nga Prokurori i Shtetit paraqet regres në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Duke pasur parasysh specifikat e trajtimit të rasteve të korrupsionit, Prokurori i Shtetit nuk duhet të lejoj ngritjen e përgjithshme të numrit të rasteve të korrupsionit. Veçanërisht kur kemi parasysh faktin se këto raste janë të deklaruara si prioritet, andaj edhe trajtimi i tyre në praktikë duhet të jetë me prioritet.



Grafiku 1: Ngarkesa me lëndë e Prokurorit të Shtetit¹.

3. Aktakuzat e ngritura

Sipas monitorimit të IKD-së, gjatë vitit 2022, Prokurori i Shtetit ka akuzuar gjithsej 98 persona për vepra të ndryshme penale nga kapitulli veprave penale të korrupsionit.² Sipas numrit të personave të akuzuar për korrupsion e para renditet Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) dhe më pas e dyta Prokuroria Themelore në Prishtinë. Derisa me numrin më të vogël të personave të akuzuar për vepra penale korruptive e fundit për nga renditja është Prokuroria Themelore në Ferizaj.

¹ Përgjigje nga KPK për IKD, më 22 shkurt 2023.

² **Shënim:** Kodi nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës në kapitullin XXXIII ka paraparë 17 vepra penale korruptive.

Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat statistikore lidhur me numrin e aktakuzave të ngritura sipas Prokurorive në vend (*Shih Grafikon nr.2*):

PROKURORIA	NUMRI I PERSONAVE TË AKUZUAR	PROFIL I LARTË
PSRK	25	7
PTh Prishtinë	19	1
PTh Mitrovicë	10	0
PTh Gjakovë	14	0
PTh Prizren	8	0
PTh Ferizaj	3	0
PTh Gjilan	12	0
PTh Pejë	7	0
Gjithsej	98	8

Grafiku 2: Aktakuzat e ngritura nga Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2022.

4. Profili i të akuzuarve

IKD ka analizuar dhe ka identifikuar edhe profilin e të akuzuarve për vepra penale korruptive. Sa i përket profilin të të akuzuarve, nga 98 personat e akuzuar, vetëm shtatë (7) prej tyre konsiderohen të akuzuar të profilin të lartë³. Kështu, nga totali i përgjithshëm i të akuzuarve për korrupsion, sipas të dhënave të dala nga monitorimi i IKD-së, rezulton se vetëm 8% e të akuzuarve i përket profilin të lartë.

Sipas Prokurorive, aktakuza të profilin të lartë kanë ngritur vetëm PSRK (*ndaj gjashtë (6) personave*) dhe PTh në Prishtinë (*ndaj një personi*). Sa i përket PSRK-së, nga totali i personave të akuzuar nga kjo Prokurori gjatë vitit 2022, rezulton se 24% e tyre i përket profilin të lartë.

Kështu, këto të dhëna tregojnë se as gjatë vitit 2022, ndjekja penale e korrupsionit nuk ka qenë shumë e theksuar në korrupsionin e profilin të lartë.

³ Shih: Udhëzimin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për korrupsionin e Profilin të lartë. (*miratuar më 13 nëntor 2013*).

5. Ndjekja e (ish) zyrtarëve të lartë

Në dhjetor të vitit 2018, IKD kishte publikuar raportin me titull: *“Integriteti i sistemit të drejtësisë në luftimin e korrupsionit”*. Në këtë raport theksohej se: *“Gjetjet e IKD-së, dëshmojnë se aktakuzat e profilit të lartë ndodhin pothuajse gjithmonë vetëm pasi zyrtarët e lartë publikë, nuk ushtrojnë më pozitën e tyre dhe vetëm pasi të njëjtit nuk kanë ndikim të madh politik”*⁴.

Akuzimi i ish-zyrtarëve si karakteristikë e ndjekjes penale të korrupsionit të profilit të lartë ka qenë e theksuar edhe gjatë vitit 2022. Kjo pasi nga tetë (8) personat e profilit të lartë të cilët janë akuzuar për korrupsion, vetëm një prej tyre është akuzuar për pozitën që aktualisht e mbanë, derisa shtatë (7) të tjerë janë akuzuar sipas pozitave të cilat nuk i ushtrojnë më.

IKD konsideron se kjo qasje e Prokurorit të Shtetit ka vazhduar edhe gjatë vitit 2022. Për më tepër kjo praktikë tregon edhe për efikasitetin e Prokurorit të Shtetit në ngritjen e aktakuzave, ku ndaj zyrtarëve të lartë sa janë në pushtet në shumicën e rasteve nuk ngriten aktakuzat siç tregojnë gjetjet e lartcekura të IKD-së, por se këto aktakuza ngriten tek pasi këta zyrtarë kalojnë në statusin e *“ish-zyrtarëve”*.

6. Koha e kryerjes së veprave penale për të cilat është ngritur aktakuza

Në drejtim të luftimit efektiv dhe efikas të korrupsionit, e rëndësishme është që si ndjekja ashtu edhe gjykimi i korrupsionit të bëhet me efikasitet të plotë. Zbulimi efikas i korrupsionit paraqet reagim të shpejtë institucional ndaj kësaj dukurie. Rrjedhimisht edhe parandalim dhe gjykim më efikas.


Sa i përket aktakuzave të ngritura gjatë vitit 2022, konsiderohet si pozitive fakti se numri më i madh i aktakuzave kanë të bëjnë me veprat penale që dyshohen të jenë kryer relativisht vonë. Duke mos paragjykuar fajësinë e të dyshuarve, në përgjithësi, kjo mënyrë e veprimit tregon për reagim të shpejtë të Prokurorit të Shtetit në këto raste.

Mirëpo, ky efikasitet i Prokurorit të Shtetit nuk ka ndodhur në të gjitha rastet. Kjo pasi, në dy (2) raste ku akuzohen gjashtë (6) persona janë ngritur aktakuza për vepra penale që dyshohet të jenë kryer qysh në vitin 2015. Kështu, aktakuza është ngritur pas rreth shtatë (7) viteve prej kur dyshohet të jetë kryer vepra penale. Rast ilustrativ për këtë është rasti ndaj të akuzuarit Mirdi Strana, si kryetar i Këshillit Drejtues të Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë dhe katër (4) anëtarëve të këtij Këshilli. Të akuzuarit në këtë rast po akuzohen se në qershor të vitit 2015 duke shfrytëzuar pozitën e tyre kanë tejkaluar kompetencat ligjore me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore. Aktakuza për këtë rast është ngritur me 16 qershor 2022, dhe tek pas tetë (8) muajve ishte mbajtur shqyrtimi fillestar, ku paraprakisht deri tek mbajtja e shqyrtimit fillestar ishin

⁴Miftaraj,E & Musliu,B & Mehmeti, H. *“Raporti integriteti i sistemit të drejtësisë në luftimin e korrupsionit”*. Prishtinë. Dhjetor 2018, fq.4.

planifikuar të mbaheshin dy (2) seanca gjyqësore, por që të dyja këto seanca të planifikuara kishin dështuar të mbahen.⁵

Përpos që kjo qasje konsiderohet negative, për shkak të vonesës së Prokurorit të Shtetit në hetimin e këtyre rasteve, kjo mënyrë e veprimit rrit potencialin për parashkrim absolut të rasteve të korrupsionit, për shkak të ngushtimit të afatit për gjykimin e këtyre rasteve.



Grafiku 3: Numri i personave të akuzuar sipas viteve kur dyshohet të jetë kryer vepra penale.

7. Dëmi sipas aktakuzave

Sa i përket dëmit të pretenduar përmes veprave penale korruptive⁶ për të cilat Prokuroria ka ngritur aktakuza, dominon vlera e dëmit në mes 10.000 deri në 50.000 euro. Rasti me dëmin më të lartë të pretenduar nga Prokuroria është aktakuza në rastin “53 milionëshi”, ndaj ish-ministrit Pal Lekaj dhe tre (3) të akuzuarve të tjerë.⁷


⁵ “Deklarohen të pafajshëm ish-anëtarët e Këshillit Drejtues të Spitalit të Mitrovicë, të akuzuar për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 7 mars 2023. (Shih linkun : <https://betimiperdrejtesi.com/https-betimiperdrejtesi-com-wp-admin-postphpost157968actionedit/?fbclid=IwAR2Kir1TFE7AaBy6jBiFuZjPbmwhrY9pr7DVT1bpjGgf1jyu6gt145VEKvQ>). (Qasur për herë të fundit më 5 prill 2023).

⁶ **Shënim:** Përfashtim në këtë rast bëjnë veprat penale nga neni 422, 430 të Kodit NR. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës apo rastet kur nuk ka informata nëse është shkaktuar dëm.

⁷ ““53-milionëshi”, ish-ministri Hasani thotë se nëse s’do paguheshin këto 53 milionë, Kosova do humbte në arbitrazh 200-300 milionë euro”. Betimi për Drejtësi. 4 prill 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/53-milioneshi-ish-ministri-hasani-thote-se-nese-sdo-paguheshin-keto-53-milione-kosova-do-humbte-ne-arbitrazh-200-300->

Sa i përket dëmit të pretenduar, ndaj gjithsej 22 personave, Prokurori i Shtetit nuk ka përcaktuar fare në aktakuzë dëmin që pretendohet të jetë kryer nga vepra penale. Mos përcaktimi i lartësisë së dëmit të pretenduar në aktakuzë vështirëson gjykimin mbi një aktakuzë të caktuar, veçanërisht nisur nga fakti se në rrethana të caktuara, lartësia e dëmit paraqet formë të kualifikuar të një vepre penale.

Po ashtu, mos përcaktimi i lartësisë së dëmit ia vështirëson gjykatës vendosjen mbi kërkesën pasurore juridike si dhe për shqiptimin e dënimit plotësues “*urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit*”. Për këtë arsye, në secilin rast, Prokuroria duhet të angazhohet që në fazën e hetimeve ta saktësojë lartësinë e dëmit të pretenduar dhe këtë element ta bëjë pjesë të aktakuzës.



Grafiku 4: Dëmi i pretenduar sipas aktakuzave për korrupsion, të ngritura gjatë vitit 2022.

8. Provat e prokurorisë

Në mënyrë që të identifikohet se me çfarë provash Prokurori i Shtetit ka ngritur aktakuzat për korrupsion, IKD ka analizuar 20 aktakuza të kësaj natyre të përzgjedhura sipas metodës rastësore. Dy (2) aktakuza të ngritura nga PSRK-ja, katër (4) të ngritura nga PTh në Prishtinë, gjashtë (6) nga PTh në Prizren, gjashtë (6) nga PTh Gjakovë dhe me nga një PTh në Pejë dhe PTh në Ferizaj.

IKD ka gjetur se në asnjë nga këto aktakuza, Prokurori i Shtetit nuk ka aplikuar masat të fshehta me rastin e zhvillimeve të hetimeve. Në pesë (5) raste janë përdorur si prova komunikimet elektronike, ndërsa në dy (2) raste të tjera si prova janë përdorur urdhëresa dhe autorizime për pagesa.

[milione-euro/?fbclid=IwAR0wvz9GhHc9bnuHZXeF9oDNPPClbTkt_9Ip_GGupl5wWwi0CYKO1_0LzXc](https://www.milione-euro/?fbclid=IwAR0wvz9GhHc9bnuHZXeF9oDNPPClbTkt_9Ip_GGupl5wWwi0CYKO1_0LzXc)). (Qasur për here të fundit më 5 prill 2023).

Në anën tjetër, në 10 raste si prova janë përdorur deklaratat e palëve, në nëntë (9) raste kontratat, në shtatë (7) raste raportet e policisë, në shtatë (7) raste tjera dëgjimi i dëshmitarëve, në shtatë (7) raste vendime të caktuara si dhe në gjashtë (6) raste procesverbale të caktuara etj.

Ngritja e aktakuzave duke u bazuar kryesisht në deklaratat e palëve, kontratat, vendime, raporte të policisë e procesverbale më tepër i ngjanë një hetimi administrativ se sa një hetimi penal për vepra penale të korrupsionit. Siç është theksuar nga IKD në raportin e kaluar mbi trajtimin e rasteve të korrupsionit *“Nisur nga fakti se korrupsioni, veçanërisht ai i profilit të lartë, është kategori komplekse e veprave penale dhe supozohet se kryhet me një planifikim të madh, kjo kategori kriminale nuk mund të trajtohet me llojet e njëjta të provave të cilat përdoren në rastet e tjera”*.⁸

Për këtë arsye, me qëllim të rritjes së efikasitetit në ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit, Prokurori i Shtetit duhet ta ndërrojë fokusin e hetimit, në kuptim të provave që kërkon dhe shqyrton gjatë një procedure penale. Kjo në mënyrë që hetimi penal i korrupsionit mos të shndërrohet në një hetim që më tepër i ngjanë një hetimi administrativ.

Duhet theksuar se aplikim i teknikave të veçanta hetuese në rastet e korrupsionit është përcaktuar edhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit.⁹

⁸ Gashi, L & Hoxha, A. “Lufta në tentativë kundër korrupsionit”. Prishtinë. Korrik 2022. Fq. 18.

⁹ “Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit”. 2004, neni 50. (Shih linkun: https://www.unodc.org/documents/brussels/UN_Convention_Against_Corruption.pdf). (Qasur për herë të fundit më 5 prill 2023).

Raporte të tjera

11

Prova të tjera

11

Deklaratat
e palëve

10

Kontratat

9

Raportet
e policisë

7

Dëgjimi
i dëshmitarëve

7

Vendime

7

Procesverbale

6

Komunikime
elektronike

5

Foto dokumentacione
dhe video-incizime

5

Ekspertiza

4

Vërtetime mbi marrjen
e përkohshme
të sendeve

4

Dosja e tenderit

3

Urdhërpagesa dhe
autorizime për pagesa

2

Opinione

2

Certifikata

2

Vërtetime

2

Marrëveshje për
pranim të fajësisë

1


Transkriptim
të bisedave

1

Grafiku 5: Provat e Prokurorit të Shtetit në aktakuzat e rasteve të korrupsionit.

9. Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nga 20 aktakuzat e analizuar për qëllime të këtij raporti, IKD ka gjetur se në vetëm katër (4) prej tyre Prokurori i Shtetit përmes aktakuzës ka bërë kërkesë për sekuestrim apo konfiskim të dobisë pasurore të përfituara me vepër penale, derisa këtë nuk e ka bërë në 16 raste të tjera. Kështu, shprehur në përqindje, i bie se Prokurori i Shtetit në vetëm në 20% të aktakuzave ka bërë kërkesë për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë së përfituar me vepër penale.




Grafiku 6: Kërkesat për sekuestrim dhe konfiskim në 20 aktakuza të analizuar

Kjo mënyrë e veprimit ndërton argumentin se sistemi i drejtësisë nuk është i vëmendshëm sa i përket domosdoshmërisë së luftimit të korrupsionit përmes konfiskimit të pasurisë së përfituar në mënyrë të kundërligjshme. Në këtë drejtim, mungesa e kërkesave për sekuestrim apo konfiskim nga Prokurori i Shtetit, tregon qartë mungesën e rezultateve në luftën ndaj korrupsionit, kjo pasi përgjegjësia kryesore bie pikërisht mbi Prokurorin e Shtetit pasi i njëjti përfaqëson aktakuzën në Gjykatë.

Duke e njohur rëndësinë e konfiskimit në fushën e parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit, në rastin konkret atij të korrupsionit, IKD i bënë thirrje sistemit të drejtësisë që të ndryshojë qasje në këtë fushë, duke rritur fokusin në konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

GJYKIMI I KORRUPSIONIT



10. Gjykimi i korrupsionit në shkallë të parë

Përkundër miratimit të Planit Strategjik për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar 2022-2024, numri i lëndëve të pazgjidhura të korrupsionit gjatë vitit 2022 ka shënuar rritje. Kjo pasi gjatë këtij viti, gjykatat në shkallë të parë nuk arritën që të zgjidhnin lëndë aq sa pranuan.

Në fillim të vitit 2022, gjykatat kishin në punë 275 lëndë të korrupsionit. Përkundër që qëllimi ishte zvogëlimi i këtij numri, në fund të vitit 2022, ky numër u ngrit për tetë (8) lëndë. Ndërsa, numri i personave të akuzuar u ngrit për 11 persona.¹⁰

Kështu, IKD gjen se gjatë vitit 2022 është shënuar regres sa i përket efikasitetit të trajtimit të rasteve gjyqësore të korrupsionit.



Grafiku 7: Ngarkesa e gjykatave të shkallës së parë me lëndë të korrupsionit.

11. Vjetërsia e lëndëve aktive në gjyqësor

Kategorizimi i lëndëve të korrupsionit si lëndë me prioritet absolut nuk është reflektuar në praktikë. Përkundër këtij përcaktimi, gjykatat nuk kanë zgjidhur këto lëndë brenda afateve të përcaktuara me ligj.


Përtej afateve të përcaktuara me ligj, IKD gjatë monitorimit ka gjetur raste të korrupsionit të cilat janë aktive në gjykatë, përkundër se aktakuza është ngritur në vitin 2009. Pra, afro 14 vite më parë. Në këtë drejtim, janë gjithsej nëntë (9) raste gjyqësore të korrupsionit, aktakuzat e të cilave janë ngritur nga viti 2009 deri në vitin 2015, e të cilat mbeten ende aktive në gjyqësor.

Rast Iluustrativ për këtë është rasti ndaj ish-kryepunëtorit të Trepçës Zhivorad Millutinoviq, që akuzohet se ka përvetësuar argjend në vlerë prej 40 mijë euro. Në këtë rast ishin caktuar 11 seanca, nga të cilat gjashtë (6) janë mbajtur, ndërsa pesë (5) prej tyre kanë dështuar të mbahen. Seanca e

¹⁰ Përgjigje nga KGJK për IKD, më 16 mars 2023.

fundit për këtë rast ishte mbajtur në vitin 2018, dhe nga seanca e fundit kanë kaluar pesë (5) vite. Ky rast është kthyer në rigjykim një herë dhe ende nuk ka marr epilog pavarësisht se aktakuza është ngritur qysh para afro 14 vitesh.¹¹

Fakti që në sistemin gjyqësor vazhdojnë të gjykohen raste të korrupsionit aktakuzat e të cilave janë ngritur qysh para afro 14 viteve tregon për mos efikasitetin e gjyqësorit në zgjidhjen e këtyre rasteve, e për më tepër tregon edhe për dështim të Planeve të brendshme të KGJK-së për zgjidhjen me prioritet të rasteve të korrupsionit. (Shih faqe 23)



Grafiku 8: Lëndët aktive të korrupsionit në gjykata, sipas viteve të ngritjes së aktakuzës.

¹¹ “Mungesa e ekspertizës bllokoi gjykimin ndaj ish-kryepunëtorit të Trepçës i akuzuar se përvetësoi argjend në vlerë prej 40 mijë euro”. Betimi për Drejtësi. 26 shkurt 2023. (Shih linkun: https://betimiperdrejtesi.com/mungesa-e-ekspertizes-bllokon-gjykimin-ndaj-ish-kryepunetorit-te-trepces-i-akuzuar-se-pervetesoi-argjend-ne-vlere-prej-40-mije-euro/?fbclid=IwAR3Sbgv9zMrC82b5HnF6e3sFSrMqn1LPUmzykr3LZ3_SPONOTLTCu6OLz0A). (Qasur për herë të fundit më 6 prill 2023).

12. Gjykimi i korrupsionit në shkallë të dytë

Efikasiteti në trajtimin e lëndëve të zgjidhura ka pësuar regres edhe në Gjykatën e Apelit. Kjo pasi për dallim nga fillimi i vitit 2022, numri i lëndëve të pazgjidhura ka pësuar ngritje në fund të vitit. Kjo pasi as Gjykata e Apelit gjatë vitit 2022 nuk ka arritur që të zgjidhë lëndë aq sa ka pranuar.

Kështu, përderisa në fillim të vitit 2022, Gjykata e Apelit ka pasur tetë (8) lëndë të pazgjidhura, ky numër është ngritur në 19 lëndë në fund të këtij viti.¹²



Grafiku 9: Ngarkesa e Gjykatës së Apelit me lëndë të korrupsionit.

Sa i përket mënyrës së vendosjes, në 33 raste të korrupsionit, Gjykata e Apelit vërtetoi aktgjykimet e nxjerra nga Gjykatat Themelore. Në 10 raste Gjykata e Apelit ndryshoi vendimet e shkallës së parë, në pesë (5) prej të cilave ashpërsoj dënimin, në aq sa edhe zbuti.

Në trajtimin e lëndëve të korrupsionit nga Gjykata e Apelit, kthimi i lëndëve në rigjykim vazhdon të mbetet problematikë. Nga gjithsej 64 lëndë të vendosura në vitin 2022, Gjykata e Apelit kthej në rigjykim 21 prej tyre. Shprehur në përqindje i bie se 32.8% e lëndëve të korrupsionit në të cilat ka vendosur Gjykata e Apelit janë kthyer në rigjykim. Pra, afërsisht çdo e treta lëndë.

Rasti ndaj ish-kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) Ilir Dushi, dhe të zyrtarit Bersan Kolgeci është një nga rastet që dëshmon më së miri për kthimin e shpeshtë të rasteve në rigjykim.

Sipas monitorimit të IKD-së, ky rast kishte filluar sipas kallëzimit penal të parashtruar nga Policia e Kosovës më 10 shtator 2013, derisa aktakuza ishte ngritur më 10 mars 2014. Shqyrtimi fillestar për këtë rast ishte mbajtur më 26 nëntor 2014. Për këtë rast janë caktuar 27 seanca, 19 nga të cilat janë mbajtur, ndërsa tetë (8) prej tyre kanë dështuar të mbahen. Gjykata e Apelit këtë rast e ka kthyer në rigjykim tre (3) herë, duke bërë që të akuzuarit të gjykohen nga shkalla e parë për të katërtën (4) herë.¹³

¹² Përgjigje nga Gjykata e Apelit për IKD, më 15 mars 2023.

¹³ “Pas tri aktgjykimeve dënuese, ish-kryeshefi i AKPPM-së dhe zyrtari tjetër lirohen nga akuza për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 22 dhjetor 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-tri-aktgjykimeve-denuese-ish-kryeshefi-i-akppm-se-dhe-zyrtari-tjeter-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion>)

Dukuria e kthimit të madh të rasteve në rigjykim flet për paaftësi të konsiderueshme të sistemit gjyqësor për të përfunduar lëndët në mënyrë efikase dhe profesionale. Për më tepër, është pikërisht kthimi i shpeshtë i rasteve në rigjykimin njëra ndër arsyt e parashkrimit të rasteve të korrupsionit.¹⁴



Grafiku 10: Vendimmarrja e Gjykatës së Apelit në rastet e korrupsionit.

13. Politika ndëshkimore në rastet e korrupsionit

Në shumicën e rasteve të korrupsionit, dënimet e shqiptuara kanë qenë dënime me gjobë. Sipas të dhënave të KGJK-së, ndaj 27 personave, gjykatat kanë shqiptuar dënime me gjobë, ndaj 15 personave kanë shqiptuar dënime me burgim, derisa në tri (3) raste kanë shqiptuar dënime me kusht. Shprehur në përqindje, i bie se në 60% të rasteve, dënimet e shqiptuara për korrupsion kanë qenë dënime me gjobë.¹⁵



[korrupsion/?fbclid=IwAR1bObQB5IxKBM1iTTSP6ouAMc_Jz4h-Plr5rg9k6iPO2WCfbJ7REuUIofA](https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/Final-Raporti-Parashkrimi-i-korrupsionit-2022.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 6 prill 2023).

¹⁴ “Parashkrimi i Korrupsionit”. IKD. Prishtinë. Dhjetor 2022. Fq.7 (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/Final-Raporti-Parashkrimi-i-korrupsionit-2022.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 5 prill 2023).

¹⁵ Përgjigje nga KGJK për IKD, më 16 mars 2023.

Grafiku 11: Politika ndëshkimore në rastet e korrupsionit.

Politika ndëshkimore në rastet e korrupsionit ishte subjekt i trajtimit të raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën. Në këtë raport, ndër të tjera theksohej se dënime të shqiptuara ndaj zyrtarëve të nivelit të lartë shpesh ishin të buta¹⁶. Gjithashtu, politika e dënimit në lidhje me korrupsionin mbetet e çrregullt edhe sipas Raportit të Progresit për Kosovën për vitin 2022, ku ndër të tjera thuhet se gjykatat nuk zbatojnë sistematikisht udhëzimet për shqiptimin e dënimit të Gjykatës Supreme të vitit 2018.¹⁷

Politika ndëshkimore e ulët në shumicën e rasteve gjyqësore të korrupsionit, duke shqiptuar dënime të buta me burg apo dënime me kusht dhe gjobë, përçon mesazh negativ tek qytetarët dhe publiku. Me dënime të buta të shqiptuara nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit, qoftë qëllimi i karakterit ndëshkues qoftë ai preventiv.

IKD në vazhdimësi ka ngritur shqetësime lidhur me aplikimin e një politike jo adekuate ndëshkimore për rastet e korrupsionit. Përkundër dënimeve të vazhdueshme të korrupsionit, ndonëse jo ndaj profilit të lartë, dukuria e korrupsionit në Kosovë është jashtëzakonisht e evidente. Mungesa e dënimeve adekuate në këto raste krahas faktit se ndikon që qëllimet e dënimit mos të arrihen, ndikon edhe tek krijimi i kulturës së pandëshkueshmërisë, e cila kulturë në fakt ndikon konsiderueshëm në rritjen e kësaj dukurie.

Për këtë arsye, IKD i rekomandon KGJK-së dhe gjykatave që përtej miratimit të udhëzuesit për politikë ndëshkimore, të angazhohen fuqishëm dhe në mënyrë proaktive për zbatimin e këtij udhëzuesi në praktikë.

14. Mos aplikimi i dënimeve plotësuese


Dënime plotësuese do të duhej të ishin një nga “armët” më të forta të gjyqësorit për luftën efektive kundër korrupsionit, por që fatkeqësisht këto dënime po vazhdojnë të mos aplikohen ndaj veprave penale të korrupsionit edhe pse sipas legjislacionit në fuqi aplikimi i tyre është obligativ dhe jodiskrecional.¹⁸

Gjatë monitorimit të IKD-së për vitin 2022, është gjetur se nga 70 aktgjykime dënuese për korrupsion, vetëm ndaj 19 personave është shqiptuar dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksionit në administratën publike. Shprehur në përqindje i bie se dënimi plotësues është shqiptuar në vetëm 27.14% të aktgjykimave dënuese.

¹⁶ “Kosovo 2022 Human Rights Report”. United States Department of State. 200. Fq.22 (Shih linkun: https://www.state.gov/wp-content/uploads/2023/02/415610_KOSOVO-2022-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf). (Qasur për herë të fundit më 5 prill 2023).

¹⁷ Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2022.

¹⁸ Kodi Nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, Neni 62.3.



Grafiku 12: Krahasimi në mes shqiptimit të dënimeve plotësuese nga gjykatat themelore në vitin 2020, 2021 dhe 2022.

IKD në vazhdimësi në raportet vjetore të monitorimit të gjykatave kishte kërkuar që këto të fundit të shqiptojnë dënimet plotësuese në rastet e korrupsionit, por që fatkeqësisht kjo praktikë negative ka vazhduar edhe gjatë vitit 2022, ku gjykatat me mos aplikimin e dënimeve plotësuese nuk e kanë zbatuar obligimin e tyre sipas Kodit Penal dhe Udhëzuesit të Gjykatës Supreme¹⁹.

Mos aplikimi i këtyre dënimeve ku kryeseve do ju ndalohej ushtrimi i funksionit në administratë publike cenon rëndë besimin e publikut në gjyqësor por edhe në administratën publike pasi kryesit e këtyre veprave penale pas vuajtjes së dënimit mund të kthehen të ushtrojnë sërish funksione publike. Mbi të gjitha, kjo mënyrë e veprimit paraqet mos zbatim të ligjit nga ana e gjykatave.

15. Administrimi jo adekuat i rasteve të korrupsionit: Nevoja për gjyqtarin zëvendësues

Gjatë monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në gjykatat e vendit, IKD ka gjetur administrim jo adekuat të rasteve të korrupsionit. Fillimisht, gjatë monitorimit, IKD gjeti se në tetë (8) raste, procedura ka filluar nga pika zero, për faktin se nga data e fundit e seancës gjyqësore kishin kaluar mbi tre (3) muaj.²⁰ Kështu, përpos që lëndët e korrupsionit nuk u trajtuan me prioritet apo brenda afatit të përcaktuar me ligj, në këto raste kaluan mbi tre muaj nga seanca e fundit dhe rastet filluan rishtazi. Me ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale afati prej tre (3) muajsh

¹⁹ “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”. Gjykata Supreme. Qershor 2021. Faqe 50.

²⁰ **Shënim:** Sipas nenit 11, par 3 të Kodit nr.04/L-123 të Procedurës Penale: “Kur shtyrja ka zgjatur më shumë se tre (3) muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishtas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat”.

ka ndryshuar dhe tani me Kodin aktual kthimi i rasteve në pikën zero ndodh kur kanë kaluar gjashtë (6) muaj nga seanca e fundit.²¹

Në anën tjetër, IKD gjatë monitorimit identifikoi gjithsej 15 raste të cilat duhej të ktheheshin në pikën zero, për shkak se gjatë gjykimit u ndërrua ndonjë prej anëtarëve të trupit gjykues. Kjo situatë paraqet administrim jo adekuat të këtyre rasteve, të cilat përkthehen në zvarritje dhe jo efektivitet në trajtimin e rasteve gjyqësore të korrupsionit.

Për më tepër, IKD gjatë vitit 2022, ka monitoruar 1 mijë e 14 seanca gjyqësore të rasteve të korrupsionit, prej të cilave 745 janë mbajtur dhe 269 janë shtyer. Shprehur në përqindje i bie që afro 27% e seancave gjyqësore të rasteve të korrupsionit janë shtyer në gjykatat e vendit. Në raport me vitin 2021 shihet qartë që nuk ka asnjë progres në administrimin e seancave gjyqësore, pasi në nga 919 seanca gjyqësore të monitoruara nga IKD, ishin shtyer 258 prej tyre apo 28% e seancave.



Grafiku 13: Rastet e kthyer në pikën zero.

Gjykatat duhet të tregojnë kujdes sa i përket administrimit të drejtësisë, në mënyrën se si ky administrim më pastaj të reflektohet në administrimin e rasteve të korrupsionit. Përtej kësaj, me qëllim të sigurimit që rastet e korrupsionit, veçanërisht ato që mund të parashihen se do të zgjasin, mos të kthehen në pikën zero, IKD rekomandon që gjykatat në këto raste të aplikojnë dispozitën e Kodit NR. 08/L-032 të Procedurës Penale që lejon angazhimin e gjyqtarit zëvendësues. Në këto raste, situatat se kur një anëtar i trupit gjykues nuk mund të marrë pjesë në gjykim, nuk do të ndikonin që rastet gjyqësore të kthehen në pikën zero²².

16. Parashkrimi i korrupsionit

Parashkrimi apo vjetërsimi paraqet situatën kur për shkak të afatit që ka kaluar nga koha e kryerjes së veprës penale, shteti apo institucionet e sistemit të drejtësisë e humbin të drejtën për të hetuar apo gjykuar një person të caktuar për një vepër penale.


²¹ Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 307 par 3.

²² **Shënim:** Kodi NR. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 284: “Nëse parashihet se shqyrtimi gjyqësor do të zgjasë, kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga kryetari i gjykatës të caktojë një gjyqtar për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor në mënyrë që të zëvendësojë anëtarët e trupit gjykues në rast se nuk mund të marrin pjesë në shqyrtim gjyqësor. Ky gjyqtar quhet gjyqtar zëvendësues”.

Në vitin 2021 dhe 2022, IKD kishte analizuar aktakuzat e korrupsionit dhe kishte gjetur raste të cilat rrezikonin të mbeteshin të pagjykuara për shkak të përfundimit të afatit të parashkrimit.²³ Gjetjet e IKD-së lidhur me parashkrimin e këtyre rasteve ishin cituar edhe në raportin për të Drejtat e Njeriut²⁴, raport ky i publikuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH).²⁵

Gjetjet e IKD-së flasin për mos efikasitet të theksuar në trajtimin e rasteve të korrupsionit, si rrjedhojë, vetëm gjatë vitit 2022 janë parashkruar rastet ndaj 28 të pandehurve të akuzuar për vepra penale korruptive. Këta 28 persona bëjnë pjesë në gjithsej 16 raste. Dëmi, sipas Prokurorisë, në këto raste fillon nga 5 euro deri në 5.4 milion euro.

Nëse kalkulohet dëmi i pretenduar nga Prokuroria në këto raste, i bie se vetëm brenda vitit 2022 janë parashkruar rastet e korrupsionit, dëmi në të cilat kalon vlerën prej 6 milion eurove. Madje, kjo vlerë llogaritet të jetë vetëm për 11 raste të korrupsionit, pasi në pesë (5) raste të tjera, Prokuroria nuk e ka përcaktuar dëmin në aktakuzë.²⁶



Grafiku 14: Parashkrimi i rasteve të korrupsionit gjatë vitit 2022 dhe dëmi i shkaktuar.

Problem i parashkrimit duket se do të jetë evident edhe gjatë viteve pasuese, pasi janë mbi 101 të akuzuar të tjerë për vepra penale të korrupsionit zyrtar, rastet e të cilëve parashkruhen brenda tri viteve të ardhshme. Duke pasur parasysh praktikën e deritanishme, rreziku i parashkrimit të këtyre

²³ Gashi L. dhe Shala G. “Korrupsioni në prag të vjetërsimit”. IKD. Prishtinë. Dhjetor 2021. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2021/12/Korrupsioni-ne-prag-te-vjetersimit-Final.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 5 prill 2023).

²⁴ “DASH citon Institutin e Kosovës për Drejtësi kur flet për parashkrimin e lëndëve të korrupsionit”. Betimi për Drejtësi. 20 mars 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/dash-citon-institutin-e-kosoves-per-drejtesi-kur-flet-per-parashkrimin-e-lendeve-te-korrupsionit/>). (Qasur për herë të fundit më 5 prill 2023)

²⁵ “Kosovo 2022 Human Rights Report”. United States Department of State. 200. Fq.22 (Shih linkun: https://www.state.gov/wp-content/uploads/2023/02/415610_KOSOVO-2022-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf). (Qasur për herë të fundit më 5 prill 2023).

²⁶ “Parashkrimi i Korrupsionit”. IKD. Prishtinë. Dhjetor 2022. Fq.4 (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/Final-Raporti-Parashkrimi-i-korrupsionit-2022.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 5 prill 2023)

rasteve është shumë i madh. Andaj, ky fenomen negativ duhet të trajtohet me prioritet dhe seriozitet të plotë nga KGJK dhe gjykatat në atë mënyrë që të mos lejohet të arrihet afati i parashkrimit. Në këtë drejtim, zbatimi më efektiv i planeve të brendshme të KGJK-së për këtë problematikë është i domosdoshëm.

17. Zbatimi i planeve të brendshme kundër korrupsionit

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) në tetor të vitit 2021 ka miratuar Planin Strategjik për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar 2022-2024. Zvogëlimi i numrit të rasteve të korrupsionit dhe trajtimi me prioritet absolut i tyre sipas standardeve ndërkombëtare për trajtimin e rasteve kanë qenë objektivat kryesore që i ka pasur Këshilli me këtë Plan. Barra kryesore për përmbushjen dhe mbikëqyrjen e këtij plani iu është dhënë kryetarëve të gjykatave dhe Koordinatorit të caktuar nga Këshilli.

Mirëpo, ky plan fatkeqësisht nuk ka gjetur zbatim të duhur. Gjatë monitorimit, IKD ka gjetur se miratimi i këtij plani nuk ka ndryshuar mënyrën e trajtimit të rasteve. Se ky plan nuk ka gjetur zbatimin e duhur e konfirmon edhe vetë raportimi në KGJK i gjyqtarit Afrim Shala, kryetar i Komisionit për Monitorimin, Vlerësimin dhe Raportimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 – 2025 si dhe i Planit Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimin të organizuar 2022 – 2024. Sipas tij, subjektet përgjegjëse nuk kishin arritur që ti përmbushin në tërësi detyrimet dhe përgjegjësitë që derivojnë nga ky plan.²⁷

Nevoja e zbatimit të strategjive është theksuar si domosdoshmëri edhe në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2022. Ku ndër të tjera thuhet: “ *Gjatë periudhës raportuese, Këshilli Gjyqësor miratoi planin strategjik për zgjidhjen efikase të rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar, një strategji komunikimi për 2022-2024 si dhe planin strategjik për qasje në drejtësi për 2022-2025. Megjithatë, këto plane nuk përmbajnë gjithmonë lidhje të qarta me strategjitë përkatëse. Zbatimi i strategjive duhet të monitorohet në mënyrë efektive*”.²⁸

Nga monitorimi i IKD-së është gjetur se mbi 14 lëndë të korrupsionit janë lëndë aktakuzat e të cilave janë ngritur që nga viti 2009 e deri në vitin 2016. Për të gjitha këto raste as gjatë vitit 2022 nuk ka pasur epilog përfundimtar. Andaj, çështja e prioritizimit si duket ka mbetur vetëm një plan në letër por pa gjetur zbatim adekuat në praktikë.

Çështja e prioritizimit shihet më së miri edhe tek rastet e kthyera në pikën zero për shkak të kalimit të afatit 3 mujor.(Shih faqet nr.20-21).

²⁷ “Nuk ka gjetur zbatim të plotë Plani për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimin të organizuar”. Betimi për Drejtësi. 2 shkurt 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/nuk-ka-gjetur-zbatim-te-plote-plani-per-zgjidhjen-efikase-te-lendeve-te-korrupsionit-dhe-krimin-te-organizuar/>). (Qasur për herë të fundit më 22 mars 2023).

²⁸ Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2022.